

VENDIM
Nr. 44, datë 29.3.2024

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS SHQIPTARE TË
FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE (AAES) PËR DISA NDRYSHIME DHE
KUFIZIME NË ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 186, DATË
6.6.2023**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 33, pika 1, germa “a”, 105 dhe 144, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të neneve 5, pika 23, 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 661/2 prot., datë 27.3.2024, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 6.6.2023, vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022.

2. Të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë përjashtohen deri në datën 31.12.2023 nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, në nenet 2.1 dhe 2.2, si dhe në nenet 4.1. dhe 4.2.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, shoqata AAES, me anë të shkresës nr. 1812 prot., datë 18.12.2023, protokolluar në ERE me nr. 2536 prot., datë 19.12.2023, paraqiti një kërkesë për derogim të pjesshëm të dispozitave të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022, duke pretenduar se furnizuesit alternativë adresojnë një numër mjaft të kufizuar klientësh fundorë dhe për këtë arsye, sipas shoqatës është e rëndësishme të ketë një ndarje të qartë të detyrave, përgjegjësi dhe të drejtave të furnizuesve, ndarje e cila t’i atribuohet nivelit të tensionit të klientit fundor, si dhe të reflektojë koston e operimit të furnizuesve.

- AAES-ja pretendon se në caktimin e detyrimeve të cilat duhen përmbushur nga furnizuesi, rregullorja nuk ka konsideruar faktin që numri i konsumatorëve që duhet furnizuar duhet të jetë tejet i lartë në mënyrë që të përballohen kostot e investimit në decentralizim të shërbimit të kujdesit ndaj klientit (KNK) dhe investimet e nevojshme në personel dhe sisteme menaxhimi/faturimi nga ana e furnizuesve.

- Gjithashtu, AAES-ja shprehet se duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23/2022, janë të aplikueshme vetëm për klientët fundorë të lidhur në tension të ulët, kërkohet derogimi i disa dispozitave të parashikuara në të.

- Nga sa analizuar, rezulton që gjatë viteve 2023 dhe 2024, numri i konsumatorëve që kanë dalë në treg të lirë, është ndjeshëm shumë më i ulët se totali i konsumatorëve të furnizuar në një vit kalendarik nga furnizuesi publik.

- “Rregullorja mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, ka për qëllim

ndër të tjera, mbrojtjen e interesave të klientëve në tërësi, bazuar në një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues përmes procedurave ligjore e transparente, si dhe monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licencuari ndaj klientëve të energjisë elektrike.

- Përveç sa përcaktuar në rregulloren sipërcituar, standardet bazë për sigurimin e një procesi të drejtë dhe efektiv të shërbimit të furnizimit të klientëve të energjisë elektrike i ka të parashikuara dhe në aktet e tjera nënligjore në fuqi, siç janë kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.1.2018, si dhe “Rregullorja mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 18.12.2017.

- Pavarësisht që AAES-ja nuk ka përcaktuar një afat derogimi, nisur edhe nga vendimmarrjet e mëhershme të Bordit të ERE-s por edhe nga shkalla e rëndësisë që “Rregullorja mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, ka për garantimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve të energjisë, si dhe duke pasur parasysh që Bordi i ERE-s ka diskrecion që në çdo kohe të rishohë vendimmarrjet e tij nëse rrethanat e faktit ndryshojnë, vlerësohet se përcaktimi i një afati 1-(një)-vjeçar për pezullimin e përkohshëm të dispozitave të rregullores objekt shqyrtimi, reflekton më mirë rrethanat për të cilat është adresuar kërkesa në ERE.

- Më herët, shoqëria AAES, përmes shkresës nr. 1003/2 prot., datë 1.12.2021, ka propozuar që implementimi i derogimit në dispozitat e propozuara të kësaj rregulloreje i cili shtrinte efektet në nenet 1.2 a, 1.2.b, 1.2.e, 1.2.f, 1.2.h, 1.2.j, në fund të paragrafit të shtohet: “e aplikueshme vetëm për furnizuesit që furnizojnë klientë fundorë të lidhur në tension të ulët, si dhe për furnizuesit që furnizojnë me shumë se 100 klientë fundorë”. Ky propozim është paraqitur për të justifikuar kostot e larta të investimit për të përmbushur kushtet e vendosura në këto dispozita.

- Duke qenë se një numër i madh konsumatorësh furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe nga Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.), me qëllim garantimin e mbrojtjes së tyre sa i përket shërbimit nga klienti, vlerësohet që derogimi i propozuar nga AAES-ja të aplikohet vetëm për ata furnizues që kanë mbi 100 konsumatorë gjatë një viti kalendarik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023.

2. Pika 2 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023, ndryshon dhe bëhet:
“- Furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të liberalizuar, të cilët furnizojnë njëkohësisht më pak se 100 konsumatorë, përjashtohen deri në datën **31.12.2024**, nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, në nenet 2.1 dhe 2.2, si dhe në nenet 4.1 dhe 4.2.”.

3. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me përmbajtjen si më poshtë:

“3. Të gjithë furnizuesit detyrohen të raportojnë çdo 3 muaj mbi numrin e konsumatorëve të furnizuar në treg të lirë.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nëse gjatë këtij viti rrethanat e hapjes/liberalizimit të tregut ndryshojnë.”.

4. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 6.6.2023, bëhet pika 5.

5. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 1 janar 2024.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi